



KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS (OFK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafët 1.5 dhe 1.18 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë Nr. 04/L-150, nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe nenit 27 të Statutit të Odës së Farmacistëve të Kosovës Nr. 134, datë 04.06.2024, nenit 50 të Rregullores për Zgjedhjen dhe Shkarkimin e Anëtarëve të Organeve të OFK-së Nr. 275, datë 30.12.2024, si dhe neneve 16, 17 dhe 18 të Rregullores mbi Punën e Organeve Kolegjiale të OFK-së Nr. 271, datë 30.12.2024, në mbledhjen konstituive të mbajtur më 16.06.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e Kryetarit të Odës së Farmacistëve të Kosovës

I. Mr.Ph. Kadri Bytyqi zgjedhet Kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës për Legjislaturën e IV-të, me mandat katërvjeçar **2026–2030**.

II. Të drejtat, përgjegjësitë dhe obligimet e Kryetarit të OFK-së përcaktohen me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, Statutin e OFK-së dhe aktet e tjera normative të OFK-së.

III. Kryetari i OFK-së ushtron funksionin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kompensohet sipas akteve përkatëse të OFK-së.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe është përfundimtar në procesin administrativ të brendshëm.

Arsyetim

Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës, në mbledhjen konstituive të Legjislaturës së IV-të, pas përfundimit të procedurave zgjedhore dhe certifikimit të kandidaturës për Kryetar të OFK-së nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar kandidaturën e Mr.Ph. Kadri Bytyqi.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit në përputhje me dispozitat e Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, Statutit të OFK-së dhe Rregullores për Zgjedhjen dhe Shkarkimin e Anëtarëve të Organeve të OFK-së, Kuvendi ka vendosur që Mr.Ph. Kadri Bytyqi të zgjidhet Kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës për mandatin 2026–2030.

Duke u bazuar në rezultatet e votimit dhe dispozitat ligjore e statutare në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Mr.Ph. Kadri Bytyqi;
- Anëtarëve të Kuvendit të OFK-së;
- Shërbimit Profesional të OFK-së;
- Arkivit të OFK-së;



Kryesuesi i Mbledhjes Konstituive

Mr.Ph. Ismail Halili

